

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-112/14

Prishtinë, 20 Prill 2016

Në çështjen juridike të:

P. K.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov dhe Beshir Islami, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA52687) i datës 21 gusht 2013 pas shqyrtimit të mbajtur më 20 Prill 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e P. K. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013 të datës 21 gusht 2013.**

2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/212/2013 (për sa i përket lëndës së regjistruar në AKP me numër KPA52687), i datës 21 gusht 2013.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 14 nëntor 2007 P. K. (në tekstin e mëtejshëm: Paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP) duke kërkuar ri-posedimin e 1/6 pjesë ideale të ngastrës nr.240/3 në sipërfaqe prej 09.60.00 Ha, në Zonën Kadastrale të Glllogjanit, Komuna e Deçanit (në tekstin e mëtejshëm: pronë e kërkuar).
2. Paraqitësi i kërkesës bashkë me kërkesën ka paraqitur edhe këto dokumente:
 - Vendimin për trashëgiminë nr.47/95 i lëshuar nga Gjykata Komunale në Pejë, më 09.05.1995, i cili vërteton se paraqitësi i kërkesës e trashëgon 1/6 pjesë ideale të pronës së kërkuar.
 - Vendimin nr. 770/29.03.1946 të lëshuar nga Komisioni i përbashkët për rishikim dhe ndarje të tokave të kolonët në interes bujqësor në regjionin e Kosovës dhe Metohisë lidhur me pronën e kërkuar.
3. Njoftimi i pronës së kërkuar është bërë më 02 shtator 2008 dhe gjatë njoftimit është gjet jo e zënë.
4. Askush nuk ka marrë pjesë në procedurë pranë AKP-së.
5. AKP-ja e ka siguruar *ex officio*, një fletë poseduese nga Departamenti për kadastrë që vërteton se ish ngastra nr.240/3 është një ngastrë e vjetër para fotografimit ajror gjatë dekadës 1980-1989 dhe korrespondon me ngastrat e reja 352 dhe 353 të regjistruara në fletën poseduese 103 në Zonën Kadastrale të Glllogjanit në emër të PSh OBPB PRODHIMTARIA E BIMEVE IRZNIQ.
6. Paraqitësi i kërkesës është kontaktuar nga AKP-ja më 26 korrik 2013 dhe më 02 gusht 2013 dhe është pyetur për datën e humbjes së posedimit dhe se pse vendimi për trashëgiminë nuk ishte regjistruar në Zyrën Kadastrale. Paraqitësi i kërkesës ka deklaruar se vendimi për trashëgiminë nuk është regjistruar për shkak të konfliktit të armatosur që ka ndodhur gjatë

viteve 1998-1999, dhe se ai nuk e ka humbur posedimin më 12 qershor 1999, siç përmendet në kërkesë (kjo datë nuk është shkruar nga ai). Paraqitësi i kërkesës gjithashtu ka vërtetuar se nuk ka qenë në posedim të pronës së kërkuar gjatë konfliktit.

7. KKPK-ja e ka hedhur poshtë kërkesën me vendimin e ankimuar KPCC/D/A/212/2013 të datës 21 gusht 2013. Në paragrafët 12 dhe 18 të vendimit grupor thuhet se kërkesa është jashtë juridiksionit të KKPK-së, sepse paraqitësi i kërkesës nuk ka arritur të tregoj se kërkesa përfshinë rrethanat që ndërlidhen drejtpërdrejt apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë gjatë viteve 1998-1999.
8. Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 21 shkurt 2014. Ai ka paraqitur ankesë te Kolegji i AKP-së të Gjykatës Supreme më 17 mars 2014.

Pretendimet e palës ankuese

9. P. K.(në tekstin e mëtejme: pala ankuese) pretendon se vendimi përbën gabime thelbësore dhe shkelje serioze “ të së drejtave të tij materiale dhe procedurale”.

Arsyetimi ligjor

10. Ankesa është e pranueshme sepse është paraqitur brenda afati prej 30 ditëve të përcaktuar me ligj (neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079).
11. Pala ankuese ka thënë se ai nuk ka qenë në posedim të pronës së kërkuar gjatë konfliktit dhe se ai nuk e ka humbur posedimin më 12 qershor 1999 siç përmendet në kërkesë.
12. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që ndërlidhen me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 Komisioni ka kompetencë për zgjidhjen e kërkesave pronësore dhe kërkesave për të drejtat pronësore **“që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.”**
13. Është e qartë se kërkesa në këtë rast nuk është e ndërlidhur me konfliktin e armatosur gjatë viteve 1998-1999. Prandaj, Gjykata Supreme bie dakord me vendimin e KKPK-së se kërkesa ishte jashtë juridiksionit të tij, dhe si rrjedhojë duhet të hidhet poshtë. Ankesa është e pabazuar, dhe Gjykata Supreme e ka vërtetuar vendimin e KKPK-së.

14. Në bazë të të lartcekurave, në pajtim me nenin 13.3 nën (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligin 03/L-07903/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

15. Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Beshir Islami, Gjyqtar

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it